

Republika e Kosovës


**Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief
State Prosecutor**

21 mars 2013

Për: z. Shpend Maxhuni, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Nga : Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit



**Lënda : Udhëzim lidhur me ofrimin e ndihmës viktimave të krimit, me të cilat
merret Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.**

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV) e organizuar në kuadër të Prokurorit të Shtetit, është kompetente dhe përgjegjëse për mbrojtjen dhe përfaqësimin e viktimave të krimit, ku përfshin informimin dhe sigurimin se të drejtat e viktimave të krimit respektohen. Marrë parasysh se ZMNV-ve është duke vepruar me resurse të kufizuara, më lejoni që përmes Jush të informoj Policinë e Kosovës, për rastet kur prania e Mbrojtësit të Viktimave është e obliguar për përfaqësimin e viktimës së krimit.

Në mbështetje të nenit 77 paragrafi 1, të Kodit të Procedurës Penale, Policia e Kosovës e njofton Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, konkretisht Mbrojtësin e Viktimave kujdestar, për të përfaqësuar viktimën e krimit në pajtim me neni 63 paragrafi 2 të KPPK-së.

Sipas dispozitave të sipërpërmendura, Policia e Kosovës duhet të njoftojë Mbrojtësin e Viktimave për të përfaqësuar viktimën e krimit në këto raste dhe atë për rastet që përfshijnë:

1. Dhunën në familje ;
2. Trafikim me qenie njerëzore ;
3. Veprat kundër integritetit seksual ;
4. Abuzimet dhe keqtrajtimet e fëmijëve ;
5. Vrasjet në raporte familjare , dhe
6. Në rastet tjera kur viktimat e krimit kërkon ndihmë.

Në raste më specifike ku janë të përfshira viktimat e krimit, duke u bazuara në neni 77 të KPPK, mbetet në diskrecion të Mbrojtësit të Viktimave, Prokurorit apo oficerit Policor për të vlerësuar nëse prezenca e Mbrojtësit të Viktimave është e nevojshëm për tu siguruar respektimi i të drejtave të tyre.

Në pajtim me atë që u tha më lartë, Ju lutem që këtë çështje ta adresoni tek vartësit tuaj me qëllim të zbatimit të obligimeve dhe përgjegjësi që dalin nga dispozitat e lartpërmendura të KPPK.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm.